

Aktivitetet e Misionit për parandalimin e dhunës në familje



#endVAW



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Mbështetje për personelin shëndetësor rreth identifikimit, referimit dhe trajtimit të viktimave të dhunës në familje

Pesë punëtori mbi identifikimin, referimin dhe trajtimin e viktimave të dhunës në familje janë mbajtur gjatë periudhës prill – maj 2017. Rreth 100 përfaqësues të spitaleve, qendrave të mjekësisë emergjente dhe qendrave kryesore të mjekësisë familjare, si dhe të njëjësive kundër dhunës në familje të Policisë së Kosovës morën pjesë në këto punëtori dhe mësuan më shumë rreth kornizës përkatëse ligjore dhe asaj të politikave, si dhe roleve dhe përgjegjësisë të institucioneve shëndetësore sipas *Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje*. Pjesëmarrësit diskutuan edhe rreth zbatimit të marrëveshjeve të lidhura mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Koalicionit të Strehimoreve të Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të viktimave; mënyrat e përmirësimit të mekanizmave të referimit duke pasur parasysh konfidencialitetin e viktimave potenciale dhe detyrimin ligjor të personelit mjekësor për t'i raportuar rastet e dhunës në familje; sfidat me të cilat përballen ofruesit e shërbimeve; si dhe ofrimin e trajtimit psikosocial për kryerësit e dhunës në familje.

Punëtoritë u organizuan nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, Ministria e Shëndetësisë dhe Policia e Kosovës dhe u mbajtën në Pejë, Gjakovë, Prishtinë, Prizren dhe Gjiilan.

Parandalimi i dhunës në baza gjinore nëpër shkolla

Për t'i diskutuar detyrimet e institucioneve arsimore për parandalim të dhunës në baza gjinore nëpër shkolla sipas *Procedurave Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje*, OSBE ka organizuar pesë seanca informuese me drejtorë të shkollave fillore e të mesme dhe drejtorë të drejtorive komunale të arsimit. Gjatë këtyre seancave u vu në pah roli i institucioneve arsimore në identifikimin e viktimave potenciale dhe raportimin e rasteve të njësitë kundër dhunës në familje të Policisë të Kosovës, si dhe u diskutua rreth mënyrave të përpilimit të politikave të brendshme për parandalim të ngacmimit seksual në shkolla dhe për fuqizimin e bashkëpunimit mes mësimeve, prindërve dhe psikologëve të shkollave.

Seancat informuese u organizuan nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Gjithsej 135 drejtorë të shkollave fillore e të mesme dhe drejtorë të drejtorive komunale të arsimit nga komuna të ndryshme morën pjesë në këto seanca.



Avokim për përkrahje të qëndrueshme për viktimat e dhunës në familje

Në vitin 2017, OSBE ka organizuar një tryezë diskutimi me qendrat për punë sociale, njësinë kundër dhunës në familje të Policisë së Kosovës, organizata ndërkombëtare dhe përfaqësues të ambasadave dhe zyrave ndërlidhëse përkatëse në Kosovë, për të diskutuar rreth mënyrave se si mund të ofrohet mbrojtje më e mirë dhe të sigurohet mbështetje më afatgjatë për viktimat e dhunës në familje në rajonin e Prishtinës. Të 26 përfaqësuesit që morën pjesë në këtë tryezë diskutuan edhe rreth mënyrës se si mund të fuqizohet mbështetja institucionale për strehimoret për viktima të dhunës në familje dhe të sigurohet qasje e papenguar në shërbimet e këtyre strehimoreve për viktimat.

Trajnim për gjyqtarë dhe prokurorë

OSBE ka mbështetur mbajtjen e pesë trajnimeve për rastet e dhunës në familje për gjyqtarë, prokurorë, mbrojtës të viktimave dhe punëtorë socialë nga rajonet e Gjilanit, Prishtinës, Gjakovës dhe Mitrovicës. Me ligjërues nga Akademia Gjyqësore e Kosovës, trajnimet u mbajtën në prill dhe maj të vitit 2017 dhe shërbyen për ofrimin e njohurive më të thella mbi Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe teknikat e hetimit dhe ndjekjes sipas këtij ligji.

Tryeza të rumbullakëta mbi rastet e dhunës në familje në sistemin e drejtësisë

Me qëllim përmirësimin e trajtimit të rasteve të dhunës në familje, në korrik 2017 u mbajt një tryezë për ngritje të kapaciteteve me 24 gjyqtarë, prokurorë, zyrtarë policorë, përfaqësues të qendrave për punë sociale dhe mbrojtës të viktimave nga rajonet e Gjilanit dhe Ferizajit. Tryeza u hap me një prezantim mbi dhunën në familje dhe u pasua me një diskutim mes pjesëmarrësve rreth natyrës së rasteve të dhunës në familje, veçanërisht për sa i përket ndjeshmërive kulturore dhe kompleksitetit të ndjekjes së këtyre rasteve. Pjesëmarrësit dolën në përfundimin që këto raste duhen trajtuar me prioritet dhe, për tu trajtuar me sukses nga sistemi i drejtësisë, të gjitha institucionet e përfshira duhet të kenë përgatitje profesionale dhe t'i respektojnë dispozitat ligjore.



Monitorimi i seancave gjyqësore: vlerësim i reagimit të sistemit të drejtësisë ndaj dhunës në baza gjinore

Monitorimi dhe raportimi për rastet e dhunës në familje dhe trajtimi i tyre nga institucionet e sistemit të drejtësisë është një ndër prioritetet kryesore programatike të OSBE-së. Duke i monitoruar seancat gjyqësore për rastet e dhunës në familje, OSBE vlerëson se në çfarë mënyre institucionet reagojnë ndaj këtyre rasteve dhe jep rekomandime për veprimet korrigjuese që duhet të ndërmerren për përmirësimin e situatës. Është e vështirë të përcaktohet me saktësi numri i rasteve të dhunës në familje që janë aktualisht në sistemin e drejtësisë, duke qenë se Kodi Penal nuk e parasheh dhunën në familje si vepër penale më vete, porse e ka të shpërndarë nëpër disa vepra penale tjera korresponduese si lëndim i lehtë trupor, lëndim i rëndë trupor, kërcënim, vrasje në tentativë dhe shtrëngim. Një ndër çështjet brengosëse e vënë re gjatë monitorimit të gjykatave është shqiptimi me kohë dhe trajtimi i urdhrave për mbrojtje emergjente, si masë kufizuese ndaj kryerësit që të mos e ripërsërisë veprën. OSBE ka monitoruar më se 50 seanca gjyqësore në të cilat janë shqiptuar urdhra për mbrojtje emergjente. Përveç kësaj, OSBE përcjellë dhe informohet rregullisht rreth këtyre rasteve nëpërmjet takimeve me gjyqtarët gjegjës që shqyrtojnë rastet e dhunës në familje, mbrojtësit e viktimave, dhe duke vizituar strehimore dhe subjektet tjera përkatëse.

Mbështetje për Forumin e Gjyqtareve dhe Prokuroreve

OSBE ka mbështetur Forumin e Gjyqtareve dhe Prokuroreve të Kosovës në organizimin e tryezave mbi kornizën ligjore për parandalimin e dhunës në familje dhe vështirësitë e hasura gjatë zbatimit të tij në praktikë. Tryezat mbledhën së bashku akterë të sistemit të drejtësisë, zyrtarë policorë, gjyqtarë dhe prokurorë, mbrojtës të viktimave, avokatë mbrojtës dhe zyrtarë gjegjës të komunave për barazi gjinore. Tryezat shërbyen për të ngritur çështje të përbashkëta që shqetësojnë institucionet gjegjëse pjesëmarrëse dhe adresimin e tyre në mënyrën më efikase përmes mekanizmave përkatës ligjorë dhe institucionalë për mbrojtje, kompensim dhe rehabilitim të viktimave. Për t'ua lehtësuar viktimave të dhunës në familje kërkimin e ndihmës, OSBE e ka mbështetur Forumin duke e shpërndarë Katalogun e tyre për të Drejtat e Viktimave, një dokument me referenca dhe informata kontaktuese për agjencitë gjegjëse qeveritare dhe joqeveritare që veprojnë në fushën e parandalimit dhe rehabilitimit të viktimave të dhunës në familje në secilin nga pesë rajonet e Kosovës.

Mbështetje për Grupin Punues

Ndërministror kundër Dhunës në Familje

OSBE këshillon Grupin Punues Ndërministror kundër Dhunës në Familje që përbëhet nga zëvendësministra, përfaqësues të ministrive për çështje të dhunës në familje dhe të organizatave ndërkombëtare e shoqërisë civile. Këshillimi përqendrohet tek rëndësia e zbatimit të kornizës së politikave që adreson mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës në familje, identifikimin, referimin, bashkërendimin, legjisllacionin, hetimin dhe procedurën gjyqësore, si dhe rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të dhunës në familje.

Takimet e Nën-Grupit kundër Dhunës në Baza Gjinore

OSBE është anëtare e Nën-Grupit kundër Dhunës në Baza Gjinore, nëngrup ky që vepron në kuadër të Grupit për Siguri dhe Gjini (GSGJ) dhe në përbërje ka përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe institucioneve të Kosovës. Nën-Grupi është ngritur me qëllim të promovimit, shtimit dhe bashkërendimit të përpjekjeve për barazi gjinore dhe fuqizim të grave në Kosovë, për të kontribuar në sigurinë e grave dhe burrave, dhe për të vënë në pah se gratë kontribuojnë dhe marrin pjesë në mënyrë të barabartë në formësimin e politikave të sigurisë dhe në institucione.

Mbështetje për Gjashtëmbëdhjetë Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës në Baza Gjinore

Gjashtëmbëdhjetë ditët e aktivizmit kundër dhunës në baza gjinore është fushatë ndërkombëtare e përvitshme që mbahet nga 25 nëntori deri më 10 dhjetor, për të sfiduar dhunën ndaj grave dhe vajzave. Në kuadër të fushatës për vitin 2017, OSBE dhe Sektori kundër Dhunës në Familje i Policisë së Kosovës organizuan katër seanca informuese mbi dhunën në familje dhe ngacmimin seksual për nxënës të shkollave të mesme të ulëta, lidhur me mënyrat e identifikimit, parandalimit, referimit, raportimit dhe diskutimit të rasteve të dhunës në familje dhe ngacmimit seksual. Seanca tjera për po të njëjtat tema janë mbajtur dhe me afro 150 mësimdhënës në pesë komuna të Kosovës. Gjithashtu, OSBE ka hartuar fletushka dhe ka mbështetur transmetimin e spoteve televizive për ngritjen e vetëdijes mbi dhunën në baza gjinore. Veç kësaj, OSBE ka mbështetur një shfaqje baleti me titullin “Një ditë”, që është e frymëzuar nga rrëfime të vërteta të grave kosovare dhe është realizuar për të hedhur dritë mbi një numër çështjesh gjinore përmes vallëzimit.

Vetëdijesimi i djemve rreth dhunës në baza gjinore

Përpjekjet për barazi gjinore shpeshherë kufizohen vetëm në aktivitete për fuqizim të grave, duke lënë anash burrat. Për ta ndryshuar këtë gjë, gjatë periudhës 2016 dhe 2017, OSBE ka realizuar një projekt ku ka angazhuar edhe burra e djem në promovimin e barazisë gjinore. Kështu, OSBE ka realizuar fushata vetëdijesimi dhe ka mbështetur organizatat e shoqërisë civile që punojnë me djem nëpër shkolla për t'i dhënë fund dhunës në baza gjinore. Veç kësaj, në partneritet me Fondin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Popullsi (UNFPA), OSBE ka realizuar hulumtimin e parë gjithëpërfshirës të ekonomive familjare rreth qëndrimeve dhe praktikave të burrave për një varg temash të lidhura me barazinë gjinore. Fokus i veçantë është vënë mbi dhunën në familje. Rezultatet e këtij hulumtimi të titulluar Anketa Ndërkombëtare mbi Burrat dhe Barazinë Gjinore (IMAGES) do shërbejnë për avokim të bazuar në fakte e prova gjatë 2018.

Aktivitete kundër dhunës në familje të planifikuara për vitin 2018

Fushatë në kuadër të Gjashtëmbëdhjetë Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës në Baza Gjimore përmes transmetimit të dy debateve televizive dhe realizimit të një konference me përfaqësues të lartë të institucioneve të Kosovës për të diskutuar rreth sfidave, modeleve të reja dhe mënyrave për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimave të dhunës në familje.

Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, fushata vetëdijesimi dhe aktivitete informimi rreth dhunës në baza gjimore, rolit të opinionit të gjerë dhe policisë për të kontribuar drejt ndryshimeve të këndvështrimeve dhe qëndrimeve për këtë çështje.

Mbështetje për Koordinatorin kundër Dhunës në Familje/Zëvendësministrin e Drejtësisë dhe Grupin Punues Ndërminstor kundër Dhunës në Familje për organizimin e pesë punëtorive njëditore me synim rritjen e bashkërendimit mes akterëve përkatës kundër dhunës në familje dhe ofruesve të shërbimeve, si dhe përmirësimin e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

Trajnime të avancuara për instruktorë të Policisë së Kosovës lidhur me reagimin e parë të policisë dhe ndihmën fillestare për viktimave e dhunës në familje dhe abuzimit seksual, nga të cilët pritet që më pastaj të informojnë dhe bartin njohuritë e fituara tek një numër sa më i madh i zyrtarëve policorë.

Mbështetje e 25 punëtorive njëditore me Institucionin e Avokatit të Popullit, Qendrat për Punë Sociale, Koalicionin e Strehimoreve, Agjencinë për Barazi Gjimore, Koordinatorin kundër Dhunës në Familje dhe organizatat përkatëse të shoqërisë civile me qëllim ngritjen e kapaciteteve të qëndrueshme në nivel lokal për monitorim dhe avokim në emër të viktimave që u janë shkelur të drejtat e njeriut, përfshirë këtu viktimat e dhunës në baza gjimore.

Në vitin 2018, OSBE-ja do të realizojë një hulumtim mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave, për të mbledhur të dhëna dhe për të krijuar një bazë faktuale rreth formave të ndryshme të dhunës që ushtrohet ndaj grave. Studimi do të përfshijë një mostër në nivel Kosove dhe, duke shfrytëzuar metodologjinë e Agjencisë së BE-së për të drejtat themelore, do të hulumtojë dhunën ndaj grave në situata konflikti dhe situata pas konflikti, duke kontribuar kështu në përmirësimin e politikëbërjes nga institucionet kyçe në nivel qendror dhe lokal.

Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështetë institucionet, ofruesit e shërbimeve dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile në punën e tyre për parandalimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen më efektive të të drejtave të viktimave të dhunës në familje. Gjithashtu, Misioni i OSBE-së organizon aktivitete vetëdijesimi rreth nevojës për ta eliminuar dhunën në baza gjinore.

0800 11112
#endVAW

Mësoni më shumë rreth punës së OSBE-së për parandalimin e dhunës në familje në
osce.org/mission-in-kosovo/human-rights
osce.org/mission-in-kosovo/gender-equality

Na ndiqni në
facebook.com/oscekosovo
twitter.com/oscekosovo
instagram.com/oscekosovo
youtube.com/oscekosovo

